

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8324
E shtunë, 20 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Zvicra konfirmon shtyrjen e bisedimeve ShBA - Iran



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFUNDON RINUMËRIMI I VOTAVE PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT: ÇFARË TASH?



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përfunduar rinumërimin e 185 vendvotimeve për zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit të cilat i ka fituar Lëvizja Vetëvendosje (LV) e

kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë për medie tha se ky institucion teknikisht është gati t'i shpallë rezultatet përfundimtare

por, sipas ligjit, duhet fillimisht të konsumohet afati prej 48 orësh që palët kanë për të dorëzuar ankesat eventuale për rinumërimin që përfundoi

AKTUALE



BE-ja PARALAJMËRON DISKUTIM STRATEGJIK PËR ZGJERIMIN F. 2

HAMZA DHE AMBASADORI RUDOLPH FLASIN PËR ZHVILLIMET POLITIKE DHE STABILITETIN INSTITUCIONAL F. 6

AKB-ja: NËSE EKONOMIA PO RRRITËT 5.43 %, PSE PO VARFËROHEN QYTETARËT DHE PO RËNDOHEN BIZNESET? F. 5

EKONOMI



ASK: TREGTIA ME PAKICË NË KOSOVË U RRRIT MBI 9 % NË PRILL TË 2026-s F. 8

SHOQATA E NDËRTIMIT: PUNËTORËT TA REFUZOJNË PUNËN ATY KU U RREZIKOHET JETA F. 8

SPORT



TAULANT XHAKA PËRFUNDON ME SUKSES PROGRAMIN UEFA A, NJË HAP I RI NË KARRIERËN SI TRAJNER F. 11

ÇFARË MUND TË HUMBË KOSOVA NËSE S'U BASHKOHET PROJEKTEVE TË GAZIT AMERIKAN?

F. 3

KONGRESI VJETOR I FEDERATËS EVROPIANE TË GAZETARËVE MIRATON MOCIONIN NË MBËSHËTJEJE TË MEDIEVE NË KOSOVË KUNDËR DËNIMEVE NGA KPM-ja F. 6



RENOVA
Maqedoni PUTZ
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ZVICRA KONFIRMON SHTYRJEN E BISEDIMEVE SHBA - IRAN

BERN, 19 QERSHOR - Bisedimet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, që ishin paraparë të zhvilloheshin më 19 qershor në resortin malor të Burgenstokut, nuk do të zhvillohen siç ishin planifikuar, tha Ministria e Jashtme zvicerane përmes një njoftimi të premten. "Bisedimet e planifikuara mes ShBA-së, Iranit, Katarit dhe Pakistanit janë shtyrë", u tha në njoftim. "Zvicra mbetet e gatshme të lehtësojë këto bisedime. Puna përgatitore në Burgenstok po vazhdon. Aktualisht nuk mund të ofrohen informacione të tjera", u shtua.

Njoftimi vjen pasi një zëdhënës i Shtëpisë së Bardhë tha gjatë natës të enjten se nënpresidenti amerikan JD Vance ka anuluar udhëtimin e planifikuar për në Zvicër, ku parashihej që të takohej me negociatorët iranianë për t'i nisur bisedimet për një marrëveshje të paqes për t'i dhënë fund luftës.

Shtëpia e Bardhë përmendi sfida logjistike për shtyrjen e udhëtimit të Vances.

Duke përmendur çështje "logjistike", Shtëpia e Bardhë tha se nënpresidenti amerikan JD Vance ka shtyrë udhëtimin e tij për në Zvicër për bisedime të drejtpërdrejta me Iranin, që ishin paraparë të mbaheshin më 19 qershor.

Bisedimet e 19 qershorit u parapanë të nisnin dy ditë pasi presidentët e të dyja shteteve nënshkruan një memorandum mirëkuptimi që synon përfundimin e luftës në Lindjen e Mesme. "Logjistika e këtyre negociatave nuk ka qenë kurrë e thjeshtë apo e parashikueshme", citohet të ketë thënë një zëdhënës i Shtëpisë së Bardhë, raportoi AFP-ja në orët e vona të 18 qershorit. "Deri tani, nënpresidenti nuk do të niset sonte. Presim me padurim që t'i fillojmë bisedimet teknike sa më shpejt të jetë e mundur". Më herët, agjencia iraniante e

lajmeve Tasnim raportoi se "asgjë nuk është konfirmuar" lidhur me udhëtimin e delegacionit të Teheranit në Zvicër.

Mediet iraniante cituan raportime të pakonfirmuara sipas të cilave Teherani ka shtyrë dërgimin e ekipit negociator për shkak të sulmeve të vazhdueshme izraelite në Liban.

Presidenti amerikan Donald Trump dhe homologu i tij iranian Masud Pezeshkian nënshkruan më 17 qershor një marrëveshje kornizë që synon t'i japë fund luftës gati katërmujore.

Sipas marrëveshjes fillestare, Teherani dhe Uashingtoni kanë 60 ditë kohë për të arritur një marrëveshje përfundimtare e cila përfshin kufizime ndaj programit bërthamor të Iranit dhe heqjen e sanksioneve amerikane ndaj Republikës Islamike. Marrëveshja përfshin, po ashtu, kërkesën e Iranit që Izraeli t'i ndalë



sulmet në Liban.

Në një konferencë për medie më 18 qershor, nënpresidenti Vance u tha gazetarëve se afati 60-ditor për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare midis ShBA-së dhe Iranit kishte filluar tashmë. "Mund të them se periudha 60-ditore zyrtarisht nis sot", tha Vance. Fillimisht ishte propozuar që ceremonia e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit të mbahej më 19 qershor në Gjenevë, ku pritej që nënpresidenti amerikan, JD Vance, të merrte pjesë në emër të ShBA-së, së bashku me diplomatë të lartë nga të dy vendet.

Megjithatë, Trumpi dhe Pezeshkian nënshkruan

papritur memorandumun e mirëkuptimit në mënyrë digjitale më 17 qershor.

Më pas, vëmendja u përqendrua te bisedimet teknike që pritet të zhvillohen në Gjenevë, ku negociatorët do të përpiqen ta shndërrojnë memorandumun e mirëkuptimit në një plan të hollësishëm zbatimi. "Takimi këtë fundjavë në Zvicër do të jetë mjaft kritik", tha një zyrtar i lartë amerikan, duke shtuar se çdo dështim i njëjës palë për t'i përmbushur pritjet duhet të bëhet i dukshëm "brenda ditësh ose javësh, e jo muajsh".

Lufta nisi pasi ShBA-ja dhe Izraeli filluan fushatën ajrore ndaj Iranit më 28 shkurt. Më pas, palët arritën një armëpushim të brishtë në prill. Presidenti amerikan ka thënë se Irani nuk do të ketë një armë bërthamore, teksa se voni ka paralajmëruar se nëse Republika Islamike nuk "sillet mirë" ai mund të rinisë sulmet.

BE-ja PARALAJMËRON DISKUTIM STRATEGJIK PËR ZGJERIMIN

BRUKSEL, 19 QERSHOR - Bashkimi Evropian (BE) do të mbajë këtë vjeshtë një diskutim strategjik për zgjerimin dhe reformat, gjë që pritet të konfirmohet në dokumentin përfundimtar të samitit dyditor të udhëheqësve të bllokut evropian, që mbahet më 18 dhe 19 qershor në Bruksel. "Në dritën e vullit të ri në procesin e zgjerimit dhe duke rikujtuar Deklaratën e Granadës, Këshilli Evropian do të zhvillojë në takimin e tetorit 2026 një diskutim strategjik mbi zgjerimin dhe reformat", thuhet në draft-konkluzionet e takimit të udhëheqësve, të cilat i ka parë Radio Evropa e Lirë.

Në këtë draft, samiti BE - Ballkani Perëndimor, i mbajtur më 5 qershor në Tivat të Malit të Zi, vlerësohet si një ngjarje që ka kontribuar në krijimin e një vullit të ri në procesin e zgjerimit. Pritet që diskutimi i ardhshëm

strategjik të përqendrohet në qasjen e re ndaj zgjerimit, e cila ende nuk është formalizuar, por tashmë përmendet në të paktën tri dokumente të publikuara gjatë javëve të fundit.

Propozimin e parë e paraqiti kancelari gjerman Friedrich Merz në fund të majit, kur ua dorëzoi institucioneve evropiane të ashtuquajturin non-paper. Në të, ai propozoi që vendet e Ballkanit Perëndimor të marrin statusin e vëzhguesit në BE, ndërsa Ukraina të fitojë statusin e anëtares së asociuar pa të drejtë vote.

Një ditë para samitit në Tivat u paraqit edhe dokumenti i dytë jozyrtar - propozimi franko-gjerman, që synon të gjejë zgjidhje për dinamikën e re të procesit të zgjerimit. Ky non-paper trajton vendet kandidatë që po mbeten prapa në zbatimin e reformave



institucionale, të cilat BE-ja i konsideron kusht kyç për anëtarësim.

Menjëherë pas këtij zhvillimi u publikua edhe non-paper-i i tretë, i hartuar nga Gjermania, Franca, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Në të propozohet që anëtarët e ardhshëm të BE-së të kenë të drejta të kufizuara, me qëllim mbrojtjen e funksionimit të institucioneve evropiane dhe parandalimin e çdo prapaktimi të mundshëm të

anëtarëve të rinj në respektimin e vlerave themelore evropiane. Burime diplomatike në Bruksel i konfirmuan Radios Evropa e Lirë se në mënyrë intensive po shqyrtohen opsione dhe qasje të reja për procesin e pranimit të vendeve anëtare të rinj. Burimet njëkohësisht lënë të kuptohet se zgjerimet e ardhshme ka të ngjarë të mos zhvillohen sipas modelit që është zbatuar më herët. Sipas draft-konkluzioneve shfaqet një qasje të re përmes

vënies së theksit tek "integritet gradual". Edhe pse kjo nuk thuhet shprehimisht, ky koncept lidhet me propozimin e hartuar nga kabinetet e kancelarit gjerman dhe presidentit francez. "Duke rikujtuar konkluzionet e mëparshme, Këshilli Evropian përsërit se Bashkimi Evropian do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me Ballkanin Perëndimor dhe do të mbështesë përpjekjet reformuese të rajonit në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Këshilli Evropian mbetet i përkushtuar për avancimin e integritet gradual ndërmjet Bashkimit Evropian dhe rajonit gjatë vetë procesit të zgjerimit, në një mënyrë të bazuar në merita dhe të kthyeshme", thuhet në draft-konkluzionet që udhëheqësit e BE-së pritet t'i miratojnë në përfundim të samitit.

ShBA-ja konfirmon heqjen e bllokadës detare ndaj Iranit

Uashington, 19 qershor - Komanda Qendrore amerikane (CENTCOM) konfirmoi se bllokada detare ndaj anijeve iraniante dhe porteve është hequr. "Është ndërprerë çdo përpjekje e ShBA-së për zbatimin e

bllokadës detare", tha CENTCOM në një postim në X. "Anijet tona të mëdha detare do të mbeten në zonën e përgjithshme për të siguruar që të gjitha aspektet e marrëveshjes të respektohen, zbatohen dhe të jenë

plotësisht në fuqi". Shtetet e Bashkuara vendosën bllokadën detare në mes të prillit, me qëllim që t'i parandalonin eksportet e naftës iraniante, që janë burimi kryesor i ekonomisë së vendit.

Heqja e bllokadës detare nga Uashingtoni dhe rihapja e Ngushticës së Hormuzit nga Teherani, një arterie kyç për furnizimet globale me naftë dhe gaz, janë pjesë e një marrëveshjeje kornizë të nënshkruar më 17 qershor.



ÇFARË MUND TË HUMBË KOSOVA NËSE S'U BASHKOHET PROJEKTEVE TË GAZIT AMERIKAN?



Kosova po përballet me një vendim të rëndësishëm lidhur me përfshirjen në projektet e gazit të lëngshëm natyror amerikan. Teksa qeveria mbetet e rezervuar, zëra të ndryshëm po kërkojnë që vendi të mos mbetet jashtë nismave rajonale. Debati ka hapur diskutime për rëndësinë strategjike të këtyre projekteve për Kosovën. Çfarë kostoje mund të ketë një “jo” ndaj ShBA-së?

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ngurrimi i vazhdueshëm i Kosovës për t'iu bashkuar projekteve të gazit amerikan, të shtyra rishtazi nga Shtetet e Bashkuara, ka ngritur shqetësime në vend për pasojat e mundshme ekonomike, energjetike dhe politike. Derisa qeveria në detyrë e kryeministrit Albin Kurti vazhdon të jetë e rezervuar për këtë çështje, ekspertët paralajmërojnë se mosangazhimi mund ta lërë Kosovën jashtë investimeve strategjike, t'ia kufizojë alternativat për furnizim me energji, dhe të ndikojë në marrëdhëniet me aleatin e vet kryesor, ShBA-në. Nga Ambasada Amerikane në Prishtinë e deri tek odat ekonomike në vend dhe opozita, thirrjet kanë qenë të vazhdueshme për përfshirjen e Kosovës në projektet e gazit të lëngshëm natyror (LNG) amerikan.

A e ka Kosova luksin të refuzojë projekte të tilla?

Jo, aspak, thotë Adrian Shtuni, ekspert për politikë të jashtme dhe siguri, që vepron në Uashington. Ai thekson për Radion Evropa e Lirë (REL) se Kosova s'e ka luksin të shënojë “autogol” në rrafshin e ekonomisë, sigurisë dhe strategjisë. “Refuzimi jo vetëm që do ta kthente Kosovën në një ishull të izoluar energjetik në Ballkan... por, do ta bënte këtë në kohën më të keqe të mundshme, pikërisht kur tregu global energjetik po përjeton krizë strukturore furnizimi dhe rritje galopante çmimesh për shkak të konflikteve gjeopolitike”, nënvizon Shtuni. Vende si Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia janë angazhuar tashmë në projekte të tilla të gazit amerikan. Qeveria në detyrë e Kosovës nuk

iu përgjigj pyetjeve të REL-it nëse është duke i shqyrtuar thirrjet për t'iu bashkuar projekteve, apo se çfarë vendimi do të marrë.

Shumica dërmuese e rrymës së prodhuar në Kosovë ka burim qymyri, ndërsa mungesa e saj mbulohet kryesisht nga importi. Ekspertët vlerësojnë se refuzimi i projekteve të gazit amerikan veç sa do ta thëllonte varësinë ndaj një sistemi të stërvjetruar për prodhimin e rrymës, si dhe ndaj importit me çmime gjithnjë e më të larta.

Burim Ejupi, drejtor i Institutit për Politika Zhvillimore - INDEP, në Prishtinë, shpjegon se Kosova do të mund të lidhej në projektin e gazit amerikan nga Greqia, përmes Maqedonisë së Veriut fqinje.

Por, nëse nuk bëhet pjesë e projektit, ajo do ta humbte një mundësi shumë të madhe në aspektin e zhvillimit ekonomik, mendon ai.

Ejupi thotë se investitorët e huaj, sidomos në fushën e teknologjisë, duan të investojnë në një vend ku ka energji të qëndrueshme elektrike. “Prania e gazit amerikan, përveç si siguri energjetike, do të ishte më shumë edhe garanci për investime”, thekson Ejupi për REL-in.

Ndërkohë, Shtuni ngul këmbë se Kosova “nuk guxon” ta lërë veten jashtë një nisme të rëndësishme për rajonin. “Nuk po flasim për infrastrukturë teknike, por për një arkitekturë të re energjetike në rajon, ku prezenca e ShBA-së, e integruar me vendet e

Bashkimit Evropian, do të shërbejë si kundërpeshë strategjike ndaj Rusisë”, thekson ai.

Ai vlerëson se projekti i gazit është iniciativë strategjike, prandaj dhe refuzimi i mundshëm nga Kosova do të ishte “shumëfish dritëshkurtër dhe i kushtueshëm”.

Çfarë do të rrezikonte Kosova në lidhjet e saj me ShBA-në?

Marrëdhëniet e Kosovës me aleatin e vet më të madh arritën pikën më të ulët në vitet e fundit, dhe disa prej veprimeve të Kurtit madje çuan në pezullimin e fillimit të një dialogu kyç strategjik. Dhe, ato mund të përkeqësohen, nëse vendi vendos kundër angazhimit në projektet e gazit amerikan, sepse, sipas Shtunit, ShBA-ja e sheh bashkëpunimin në fushën e energjisë si një nga shtyllat kryesore të partneritetit me vendet e rajonit.

Si shembull, ai e përmend refuzimin që qeveria e Kurtit ia kishte bërë në vitin 2021 projektit rreth 200 milionë dollarësh për ndërtimin e infrastrukturës së gazit, i financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e ShBA-së.

“Pyetja është, pas pesë vjetësh, ku qëndron revolucioni i gjelbër? Kosova është po aty ku ishte. Qasja më e përshtatshme është tranzicioni gradual, dhe jo revolucioni dramatik, pra largimi gradual nga qymyri përmes gazit”, thekson eksperti. Ai beson se, nëse Kosova përsëri e shpërfill një projekt me rëndësi

thelbësore për partneritetin e ShBA-së në Ballkan, “refuzimi nga Uashingtoni nuk do të lexohej thjesht si një rastësi, pa ndonjë të keqe”.

Në anën tjetër, Fron Nahzi, autor i librit “Grupet Etnike të Interesit dhe Politika e Jashtme e ShBA-së”, thotë për REL-in se refuzimi mund t'ia kufizojë Kosovës mundësitë për bashkëpunim ekonomik me ShBA-në në të ardhmen. “Së paku, kjo mund të forcojë perceptimin se Kosova heziton të marrë pjesë në iniciativa më të gjera rajonale, të mbështetura nga aleati i saj më i rëndësishëm strategjik”, thekson Nahzi.

Duke vepruar kështu, Kosova madje do ta humbte shansin për ta treguar veten si partnere aktive që kontribuon në zhvillimin rajonal, sigurinë energjetike dhe kufizimin e ndikimit rus dhe kinez në Evropën Juglindore, përfundon Nahzi.

Shtuni, ndërkaq, paralajmëron se pasojat e refuzimit të projektit amerikan të gazit do të ndikonin përtej marrëdhënieve ShBA - Kosovë.

Ai e sheh refuzimin e mundshëm si pengesë në rrugën e Kosovës drejt integritit. “Kycja e Kosovës në korridoret rajonale të energjisë në vetvete ka rëndësi strategjike, pasi sjell integrimin de facto me vendet e rajonit, NATO-s, BE-së, dhe me Perëndimin. Edhe me ato që nuk e njohin, si për shembull Greqia”, shpjegon Shtuni.

Prandaj, pyet ai, a nuk është integrimi ambicia dhe synimi strategjik i Kosovës?



PËRFUNDON RINUMËRIMI I VOTAVE PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT: ÇFARË TASH?

Prishtinë, 19 qershor - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përfunduar rinumërimin e 185 vendvotimeve për zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit të cilat i ka fituar Lëvizja Vetëvendosje (LV) e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë për medie tha se ky institucion teknikisht është gati t'i shpallë rezultatet përfundimtare por, sipas ligjit, duhet fillimisht të konsumohet afati prej 48 orësh që palët kanë për të dorëzuar ankesat eventuale për rinumërimin që përfundoi. Ky afat nis nga ora 12:00 e së premtes. Në rast se ka ankesa, ato më pas shqyrtohen nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës dhe nga Gjykata Supreme. Rinumërimi u bë me vendim të KQZ-së bazuar në Rregulloren Zgjedhore për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, që synon t'i adresojë problemet eventuale dhe për t'u siguruar që numërimi është zhvilluar me saktësi.

Elezi tha se do të përpilohet një raport me gjetje të hollësishme gjatë procesit të rinumërimit.

Sa mandate fituan partitë?

Sipas rezultateve preliminare, LV-ja ka fituar 42.96 për qind të votave dhe pritet të ketë 53 ulëse në Kuvendin prej 120 anëtarësh. Ky është numër më i vogël i deputetëve krahasuar me zgjedhjet e dhjetorit të vitit të kaluar, kur partia e Kurtit kishte fituar 57 mandate. Subjekti i dytë ka dalë Partia Demokratike e Kosovës me 21.13 për qind të votave të fituara dhe në legjislaturën e 11-të pritet të ketë 22 deputetë - po aq sa kishte edhe në legjislaturën paraprake. Lidhja Demokratike e Kosovës është forca e tretë me 17.60 për qind apo 18 deputetë - nga 15 deputetë sa kishte në dhjetor. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - që së voni ka vendosur të njihet si Aleanca - ka fituar 7.16 për qind të votave dhe pritet të ketë shtatë deputetë, apo një më shumë se

në dhjetor.

Nëntë nga dhjetë ulëset e rezervuara për komunitetin serb, sipas rezultatit preliminar, i ka fituar Lista Serbe, që mbështetet nga Beogradi zyrtar. Ndërkaq, një mandat ka fituar partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. Nga komunitetet joshumicës serbe, KDTP-ja ka fituar dy mandate dhe nga një kanë fituar koalicioni Vakaf, IRDK-ja, SDU-ja, NDS-ja, PSA-ja, PLE-ja, PREBK-ja dhe JGP-ja. Në zgjedhjet e 7 qershorit, dalja ishte 37 për qind, gjë që paraqet një rënie në pjesëmarrje krahasuar me rreth 45 për qind, sa ishte dalja në zgjedhjet e dhjetorit. Kandidatët më të votuar Sipas rezultateve preliminare, në top-dhjetëshen e kandidatëve më të votuar në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit, tetë prej tyre janë nga Lëvizja Vetëvendosje: Albin Kurti (LV) - 324.329 vota Glauk Konjufca (LV) - 264.338 vota Albulena Haxhiu (LV) - 165.142 vota Hekuran Murati (LV) - 137.812 vota

Donika Gërvalla (LV) - 131.844 vota Bedri Hamza (PDK) - 126.943 vota Xhelal Sveçla (LV) - 109.269 Vjosa Osmani (LDK) - 92.236 Ejup Maqedonci (LV) - 89.305 Avni Dehari (LV) - 89.184 vota

Çfarë do të ndodhë më pas?

Pasi rezultatet të jenë shpallur, më pas duhet të certifikohen nga KQZ-ja dhe vetëm pas kësaj, zyrtarisht hapet rruga për krijimin e institucioneve të reja. Deputetët e rinj kanë tri punë të rëndësishme përpara: konstituimin e Kuvendit, formimin e Qeverisë dhe zgjedhjen e presidentit të ri. Përderisa për dy të parat kërkohet shumica e thjeshtë prej 61 votash - dhe LV-ja mund t'i bëjë numrat së bashku me pakicat joserbe - për presidentin duhen dy të tretat e votave. Zgjedhjet e 7 qershorit u mbajtën pikërisht për shkak të dështimit të deputetëve që të zgjedhin pasardhësinë e Vjosa Osmanit brenda afatit kushtetues, pasi ish të parës së

vendit i përfundoi mandati në prill.

Nga LV-ja kanë thënë se pas certifikimit të rezultateve do të bisedojnë me partitë opozitare për krijimin e institucioneve, ndërkaq nga partitë ish-opozitare është vënë theksi te një marrëveshje politike për tejkalimin e ngërçit.

Muaj më parë, bisedimet për çështjen e presidentit dështuan dhe në atë kohë LV-ja kishte paraqitur disa oferta për LDK-në dhe PDK-në, por që u konsideruan të papranueshme nga këto dy subjekte.

Kurti ka deklaruar se shpreson që këtë herë situata të jetë ndryshe sa i përket bisedimeve për çështjen e presidentit. "Ju e dini që në këtë pranverë, si Qeveri kemi bërë oferta të jashtëzakonshme për opozitën. Ne kemi propozuar, ata kanë refuzuar", ka deklaruar ai ditë më parë.

Sipas Kushtetutës, presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy runda e para apo me 61 vota në rundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet.

AKB-ja: NËSE EKONOMIA PO RRITET ME 5.43 %, PSE PO VARFËROHEN QYTETARËT DHE PO RËNDOHEN BIZNESET?

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) e mirëpret çdo tregues pozitiv për ekonominë e Kosovës, përfshirë deklarinë e Qeverisë së Kosovës për rritje ekonomike prej 5.43 %. Megjithatë, AKB vlerëson se kjo shifër duhet të analizohet me kujdes dhe në raport me treguesit e tjerë ekonomikë që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe në funksionimin e bizneseve. "Nëse ekonomia ka shënuar rritje prej 5.43%, ndërkohë që inflacioni ka arritur në rreth 7.5%, atëherë lind nevoja për të kuptuar se sa është rritja reale ekonomike dhe sa prej saj është konsumuar nga rritja e çmimeve. Për qytetarët dhe bizneset, rëndësi nuk ka vetëm rritja nominale e ekonomisë, por përmirësimi real i standardit jetësor dhe i aktivitetit ekonomik. AKB konsideron se kjo rritje nuk po reflektohet mjaftueshëm në sektorin privat, në prodhim,

eksport, investime të reja dhe rritje të fuqisë blerëse. Përkundrazi, bizneset vazhdojnë të përballen me kosto të larta operative, çmime më të larta të energjisë, mungesë të fuqisë punëtore dhe vështirësi në zgjerimin e aktiviteteve të tyre", ka thënë Agim Shahini, kryetar i AKB-së. Po ashtu, ai ka thënë se ekziston perceptimi se një pjesë e kësaj rritjeje mund të jetë nxitur kryesisht nga rritja e konsumit, fondet sociale, remitancat dhe shpenzimet publike, ndërsa ndikimi i sektorëve produktivë mbetet ende i kufizuar. "Një ekonomi e qëndrueshme nuk mund të mbështetet vetëm në konsum, por duhet të ndërtohet mbi prodhim vendor, investime private, eksport dhe rritje të konkurrueshmërisë. AKB kërkon transparencë të plotë lidhur me strukturën e rritjes ekonomike dhe publikimin e analizave që tregojnë qartë se cilët sektorë kanë kontribuar në



këtë rezultat dhe sa përfitime konkrete kanë pasur bizneset dhe qytetarët. Qytetarët nuk jetojnë nga statistikë, por nga fuqia e tyre blerëse. Bizneset nuk zhvillohen nga deklaratat,

por nga kushtet reale të tregut. Prandaj, sukcesi ekonomik duhet të matet me mirëqenien e qytetarëve, rritjen e investimeve, prodhimin dhe vendeve të punës, e jo vetëm me

tregues makroekonomikë", ka thënë Shahini. Ai ka shtuar se Kosova ka nevojë për rritje ekonomike reale, të qëndrueshme dhe të ndjeshme për secilin qytetar dhe biznes.

NË SELANIK U KËRKUA MBËSHTETJE MË E MADHE PËR PROJEKTET STRATEGJIKE INFRASTRUKTURE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ministri në detyrë i Infrastruktursë dhe Transportit, Dimal Basha, mori pjesë në Samitin e Investimeve në Transport, ku ishte panelist së bashku me ministrat homologë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë diskutimit ministri Basha theksoi rëndësinë e mbështetjes së projekteve infrastrukturore të Kosovës, me fokus të veçantë në projektet hekurudhore, të cilat përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit, kanë edhe rëndësi strategjike për rajonin dhe vetë Evropën. Ai kërkoi që këto projekte të mbështeten nga partnerët ndërkombëtarë, duke vlerësuar se investimet në infrastrukturë kontribuojnë në forcimin e lidhjeve tregtare, rritjen e mobilitetit dhe avancimin e integritimit ekonomik evropian. Në panel morën pjesë ministrat e transportit dhe infrastrukturës



nga vendet e Ballkanit Perëndimor, komisionari Evropian për Transportin, Apostolos Tzitzikostas, ministri grek i Infrastruktursë dhe Transportit, Christos Dimas, si dhe përfaqësues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankës Evropiane për Investime (BEI). Ministri Basha theksoi se Kosova ka projekte me rëndësi të veçantë për zhvillimin e rajonit dhe integrimin evropian, vizion të qartë për zhvillimin e infrastrukturës dhe partnerë të besueshëm për realizimin e tyre. Ai nënvizoi se mbështetja e vazhdueshme e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe partnerëve zhvillimorë mbetet kyçe për avancimin e projekteve strategjike që forcojnë lidhshmërinë rajonale dhe integrimin e Kosovës në rrjetet evropiane të transportit.

Haxhiu: Administrata profesionale, shtyllë e Kuvendit të Kosovës

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Shërbyesve Civilë, organizoi një takim me stafin administrativ të institucionit, në shenjë vlerësimi për kontributin e tyre në funksionimin dhe avancimin e punës së Kuvendit. Gjatë takimit, kryetarja Haxhiu shprehu mirënjohje për përkushtimin, profesion-

alizmin dhe angazhimin e vazhdueshëm të shërbyesve civilë, të cilët me punën e tyre të përditshme japin një kontribut të rëndësishëm në realizimin e përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit. "Shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin tim për punën, përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin e përditshëm të shërbyesve civilë, të cilët janë garancia për funksionimin

efikas të institucionit më të lartë përfaqësues e ligjvënës në vendin tonë", theksoi Haxhiu. Haxhiu falënderoi të gjithë punëtorët e administratës së Kuvendit për kontributin e tyre të çmuar në forcimin e institucioneve demokratike dhe në shërbim të interesit publik, duke u uruar sukses të mëtejshme në përbushjen e detyrave të tyre profesionale.



Konstituohet Këshilli Drejtues i Aleancës

Prishtinë, 19 qershor - Në përputhje me statutin e Aleancës, u konfirmuan 108 anëtarë me mandat katërvjeçar. Gjatë takimit

konstituiv, kryetari Ardian Gjini, i uroi të gjithë anëtarët për zgjedhjen e tyre, si dhe i falënderoi për angazhimin gjatë procesit zgjedhor, duke

kërkuar angazhim dhe mobilizim për hapat e ardhshëm në zhvillimin dhe fuqizimin e Aleancës. Së shpejti, Këshilli Drejtues do t'i

propozohet për miratim edhe Kryesia e re e Aleancës, duke përmbyllur kështu procesin e konsolidimit të strukturave drejtuese të partisë.



KONGRESI VJETOR I FEDERATËS EVROPIANE TË GAZETARËVE MIRATON MOCIONIN NË MBËSHTETJE TË MEDIEVE NË KOSOVË KUNDËR DËNIMEVE NGA KPM-JA

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Federata Evropiane e Gazetarëve e ka miratuar në mënyrë unanime në Kongresin Vjetor në Ankara mocionin në mbështetje të medieve në Kosovë që kanë qenë subjekt i gjobave joproporcionale nga Komisioni i Pavarur i Medieve.

EFJ në tekstin e mocionit ka thënë se këto dënime janë përpjekje për ta kufizuar lirinë e shprehjes dhe debatit në Kosovë dhe kanë ndodhur pas kërkesave dhe ankesave të anëtarëve të partisë në pushtet, Vetëvendosje. Kongresi Vjetor e ka autorizuar Bordin Drejtues të EFJ-së, që t'i bëjë thirrje Vetëvendosjes t'i ndalë sulmet ndaj gazetarëve dhe medieve, dhe t'i shkruajë zyrtarisht KPM-së për t'i kërkuar që të mos tejkalojë kompetencat. Presidentja e EFJ-së, Maja Sever, ka thënë se mediet dhe gazetarët në Kosovë e kanë përkrahjen e plotë evropiane për ta vazhduar punën e tyre të rëndësishme në interes të publikut.

Teksti i plotë i mocionit:

Për gjobat e vendosura nga rregullatori i mediave (KPM) në Kosovë ndaj televizioneve. Propozuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK,

Kosovë).

Kongresi Vjetor i Federatës Evropiane të Gazetarëve, i mbajtur në Ankara, Turqi, më 18-19 qershor 2026, shpreh shqetësim për presionin e paprecedentë që është ushtruar gjatë dy muajve të fundit ndaj televizioneve kryesore në Kosovë nga rregullatori i mediave në vend, Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM).

Në gjashtë mbledhje të Bordit të KPM-së janë shqiptuar gjithsej mbi 60 mijë euro gjoba ndaj disa mediave. Këto gjoba lidhen kryesisht me shkelje të pretenduar të Kodit të Etikës gjatë fushatave zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme të shkurtit 2025, dhjetorit 2025 dhe qershorit 2026.

Vërejmë se gjobat janë vendosur pas ankesave të politikanëve nga partia në pushtet lidhur me diskutimet për punën e tyre në debatet televizive, të zhvilluara nga analistë politikë dhe përfaqësues të partive të tjera politike. Edhe më shqetësues është fakti se një nga anëtarët e KPM-së ka bërë thirrje për ndalimin e plotë të njërit prej emisioneve më të ndjekura të debatit televiziv.

Këto gjoba i shohim si një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave në Kosovë, me synim dobësimin e debatit publik dhe



kufizimin e aftësisë së mediave për ta mbajtur Qeverinë përgjegjëse për punën e saj. Kjo është një përpjekje për frikësimin e gazetarëve që mund të çojë në vetëcensurë. Shumat që duhet të paguhesh do të krijojnë barrë shtesë për televizionet, të cilat tashmë përballesh me vështirësi financiare.

Po ashtu, shprehim shqetësim të madh se disa nga mediat e shënjestruara transmetojnë në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë, dhe një prej tyre është kërcënuar me heqjen e licencës. Vendimet e KPM-së përfaqësojnë gjithashtu

ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë editoriale dhe do të dëmtojnë pluralizmin mediatik me të cilin krenohet Kosova. Kongresi Vjetor i EFJ-së gjithashtu vëren gjetjet e një raporti të publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ngrisin shqetësime se disa nga vendimet e KPM-së janë miratuar përtej afateve ligjore të përcaktuara për vendimmarrje, duke vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e tyre.

Për këtë arsye, Kongresi Vjetor i EFJ-së udhëzon Bordin Drejtues që të ndërmarrit veprimet e mëposhtme: - t'i bëjë thirrje partisë politike në pushtet,

Lëvizjes Vetëvendosje, të përmbahet nga fushatat publike të njollosjes dhe denigrimit ndaj gazetarëve dhe akterëve mediatikë në Kosovë; - t'i dërgojë një letër Komisionit të Pavarur të Medieve duke kërkuar respektimin e Ligjit për KPM-në dhe të mos tejkalojë kompetencat dhe përgjegjësitë e veta gjatë shqyrtimit të ankesave; - t'i bëjë thirrje Komisionit për Media të Kuvendit të Kosovës që të mbajë një takim urgjent me anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve për të siguruar që vendimet e tyre të mos cenojnë punën e mediave dhe lirinë e medias.

HAMZA DHE AMBASADORI RUDOLPH FLASIN PËR ZHVILLIMET POLITIKE DHE STABILITETIN INSTITUCIONAL



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka pritur të premtën në selinë qendrore të PDK-së ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet politike në vend pas zgjedhjeve të 7 qershorit dhe rëndësinë e

ruajtjes së stabilitetit institucional. Gjatë takimit kryetari Hamza ka rikonfirmuar përkushtimin e Partisë Demokratike të Kosovës për formimin sa më të shpejtë të institucioneve qeverisëse dhe për të kontribuar në forcimin e demokracisë dhe avancimin e proceseve që i shërbejnë

interesit të qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës.

Hamza e ka falënderuar ambasadorin Rudolph për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka dhënë Kosovës ndër vite si dhe për partneritetin e ngushtë dhe marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve.

Kurti takon drejtuesit e qendrave të LV-së, diskutojnë për zgjedhjet e brendshme në parti që mbahen sivjet

Prishtinë, 19 qershor - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar për takimin e mbajtur me qendrat e partisë pas zgjedhjeve të 7 qershorit. Në këtë mbledhje ka marrë pjesë edhe kreu i kësaj partie, Albin Kurti dhe zyrtarë të tjerë të partisë.

Kurti në fjalën e tij ka falënderuar qendrat për

angazhimin gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve. "Kryeministri Albin Kurti i falënderoi qendrat e Lëvizjes Vetëvendosje! për angazhimin dhe punën e palodhshme gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve. Energjia, përgjegjësia dhe puna e

treguar nga qendrat e Lëvizjes, kanë qenë vendimtare për fitoren tonë të madhe e të përsëritur. Në këtë mbledhje, ndër të tjera, u diskutua për çështje të përgjithshme organizative dhe për zgjedhjet e brendshme të Lëvizjes, të cilat do të mbahen gjatë këtij viti", ka njoftuar LV-ja.



LUTFI HAZIRI, SI VOJSA OSMANI!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Krimi zgjedhor: Për zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, Albin Kurthi i futi midis 300 dhe 400 milionë euro për korruptim të procesit zgjedhor dhe blerje të votave që për rezultat pati mbi 51 për qind të votave. Lëmosha prej 100 eurosh u nda për kategoritë më të cenueshme si pensionistët që mbijetojnë në kushte nën dinjitet minimal. Edhe përfituesit tjerë të skemave sociale u prekën nga "mëshira" e mashtruesit Kurthi dhe pisit Murati. Studentët që ishin burim i pashtershëm i çdo kundërshtimi të robërisë e që pjesa më e madhe e tyre, hiç këtu ata të pjellës dhe mendësisë jugosllave dhe serbe, u rreshtuan në radhët e së lavdishmes Ushtri Çlirimtare të Kosovës sikur që përbënin pjesën më të madhe të ish të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi. Partitë e lodhura opozitare në vend se t'i bojkotojnë këto zgjedhje të korruptuara u mjaftuan me kundërshtim gojor ndonëse nëpër Kosovë strukturat e regjimit autokrat të Kurthit shpërndanin para, thasë me miell, arka me vaj, subvencione dhe grante, punësime pa asnjë kriter, emëtime partiake në poste të larta, largime nga puna dhe degradime në pozita të veteranëve të luftës, ish të burgosurve politikë dhe çdokënd që e kishin futur në listën e "armiqve" ndonëse në botën normale ishin thjesht kundërshtarë politikë. Pjesëtarët hileçarë të diasporës i korruptuan me bileta aeroplani, autobusi, ua mbulonin shpenzimet për veturë, ua paguanin dhomat e hotelit, ua dhanë shtesat për fëmijë ndonëse ata i marrin këto shtesa në vendet ku jetojnë, iu dhanë ndihma sociale që nuk iu takojnë, iu dhanë para për tekste shkollore ndonëse ata as nuk jetojnë e as nuk shkollohen në Kosovë. Marrin paturpësisht edhe centin e fundit në Kosovë pa asnjë bazë ligjore. Këta nuk kanë asnjë lidhje me moral prandaj e bëjnë këtë. Këta mashtrues në diasporë që përfitojnë në mënyrë aq të pandershme duhet të denoncohen te autoritetet e

shteteve ku jetojnë sikur që duhet të denoncohen edhe publikisht. Kjo është baza elektorale e Kurthit në diasporë! Këta ishin dhe janë kundër luftës çlirimtare, kundër UÇK-së sepse atdhetarizmin kurrë nuk e kanë pasur afër zemrës e lëre në zemër! Edhe në zgjedhjet e 7 qershorit 2026 u përsërit e njëjta poshtërsi; korruptimi i procesit zgjedhor dhe blerja e votave përmes, së paku 150 milionë euro që u shpërndanë sipas skemës kriminale të 28 dhjetorit 2025 e ku njëra ndër hallkat kryesore të këtij krimi të organizuar ishte Vojsa Osmani, ish presidente e deklaruar nga Kurthi dhe trutharët e LV-së pasi ua caktojë datën dhe ditën për zgjedhje e që u kërkua nga keqbërësi Kurthi. Opozita e gjendur në shok postraumatik pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit, nuk pati guxim t'i bojkotojë as zgjedhjet e 7 qershori të këtij viti ndonëse ishin copy paste e zgjedhjeve paraprake, brutalisht të manipuluar, të korruptuara dhe të vjedhura. Sidomos e votave me postë dhe përfaqësi diplomatike ku LV-ja e barazon rekordin e Enver Hoxhës, Titos, Stalinit dhe Kim il Sunit me mbi 83 për qind. Ndërkaq, me votat e brendshme sillet pak mbi 40 për qind. Dhunim i trendit përmes korruptimit të votës. Opozita, në vend që të mos i pranojë këto rezultate, rri në pritje të një thirrje telefonike nga kryearkitekti i këtij krimi elektorale, KM kujdestar, Albin Kurthi. Para zgjedhjeve pata shkruar; bojkotoni zgjedhjet e kurdisura ose mos i pranoni këto rezultate. Nëse nuk e bëni këtë, trusni dhe heshtni duke u kapur për bishti të qerres së Albin Kurthit.

Heshtje mortore pas zgjedhjeve: Realisht në Kosovë nuk ka opozitë me koç... politike dhe e gatshme të sakrifkohet për një kauzë opozitare. Përveç disa analistëve dhe gazetarëve. Përveç Ramush Haradinajt dhe Përparim Ramës. Të tjerët mrrizojnë në zonën gri të komoditetit opozitar. Prandaj po sulmohet aq brutalisht dhe paturpësisht Ramush Haradinaj

dhe familja e tij nga cyberzagarët jugosllavë dhe serbë të Albin Kurthit. Prandaj po sulmohet edhe themeli mbi të cilin është ndërtuar pavarësia e Kosovës dhe vet qenia shqiptare, familja e komandantit legjendar, Adem Jashari.

Prandaj po sulmohen krerët ushtarakë dhe shtetërorë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, me shokë që po mbahen peng në Hagë.

Prandaj po marginalizohet Frymëzimi, Kuptimi dhe Përmbytja e Luftës për Çlirim, Liri, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar, Bacë Adem Demaçi. Figura më e fuqishme opozitare e që është edhe karizmatike në Kosovë sot është Përparim Rama, kryetar i Prishtinës. Po sulmohet nga Kurthi përmes amebave të pushtetit sikur penguesi pis, Hekuran Murati, paramilitari i Arsovës, antishqiptari dhe anti-UÇK, Dimal Basha dhe eminenca gri e majave të kimit të organizuar, korupsionit, antikombëtarizmit, spionimit, linçimit të çdo vlere njerëzore dhe kombëtare, madre madrinose në nëntokës së LV-së dhe Vejuhës së Zezë, Dejona Mihali. Po sulmohet edhe nga LDK-ja, nga llaskucët e Abdixhikut dhe Vojsa Osmanit nga frika se mos ua merr partinë! Nëse ua merr Kurthi, nuk ka problem, e kanë përvojën e renegates Osmani. LDK-ja, përjashtuar disa raste individuale jo që nuk e mbrojtën Ramën nga brutaliteti i një personi informal në Kosovë që vranë e kthjellë, pa asnjë pozitë dhe certifikatë sigurie siç është agjentja e dyshuar greke dhe serbe Dejona Mihali. Vojsa Osmani, Shvarc Donika, Xhelal Sfeqla dhe Albulena Haxhiu duhet t'i tregojnë qytetarëve të Kosovës se si u bë që koka e kimit të organizuar e nëntokës së LV-së dhe rrezikuesja e sigurisë së shtetit, nga persona non grata (e padëshiruar) u bë persona super grata (shumë e dëshiruar)! Duhet të sqarojnë se si një person ekstremisht i pamoralshëm si Elpis Hoxha paguhet nga buxheti i Kosovës dhe punon kundër Kosovës. Apo, i ikuri nga Muzeu i Maskave

në Shkodër nga koha e Enver Hoxhës, Hysamedin Xhehemi merr pagë nga Kosova. Etj. etj. LDK-ja, për më keq përmes zëdhënësit të LV-së brenda kësaj partie, Lumir Abdixhikut dhe llaskucëve shoqëruar i nguli thikën në shpinë Përparim Ramës pas koalicionit me PDK-në ndonëse e ka të qartë se vetëm Rama dhe PDK-ja ia mundësuan LDK-së fitoren në Prishtinë gjatë dy mandateve të fundit. Prandaj e sulmojnë Ramën për t'i pëlqyer Kurthit. Lutfi Haziri është një veteran i LDK-së që përmes aftësisë fenomenale për përshtatje i ka mbijetuar të gjitha garniturave politike, që nga përfundimi i luftës. Ditëve të fundit, si ballon provues i Abdixhikut dhe Osmanit doli me një vardisje të hapur ndaj Albin Kurthit dhe sektit të LV-së duke ofruar 18 vota për një koalicion dhe zgjedhje të presidentit. Po të njëjtin qëndrim e shprehu prej jugosllavi legjendar, Azem Vllasi, mbetje mortore e kriminelit Tito. Lutfi Haziri ka një të kaluar shumë më të mirë, më të pasur (në çdo aspekt) se Lumiri dhe Vojsa prandaj nuk duhet të shërbejë si profaturë për ambiciet karrieriste patologjike të dyshes anti-LDK, Lumir Abdixhiku dhe Vojsa Osmani. Këta të dy nuk janë as e sotmja e LDK-së e lëre më e ardhmja. Janë karrieristë patologjikë. Dhe nuk i takon Lutës të bëhet vegëza e tyre për t'u lidhur me Albinin. Nëse po, Luta me dorë të vet po e vendosë litarin në fyt. Ka pak rëndësi pastaj se kush e bënë ekzekutimin teknik, Albin, Lumiri apo Vojsa. Nuk mund Luta ta këndojë këngën e mjellmës, në mesin e korbave! Dhe nuk duhet!

Lumiri me Vojsën i përzënë nga 10-tshja e parë Avdullah Hotin dhe Hykmete Bajramin. Votuesit i kthen në 10 më të votuarit. Lumiri dhe Vojsa e larguan Arben Gashin nga hierarkia e LDK-së, votuesit e kthyen në vendin që e meriton. Lumiri dhe Vojsa bënë përpjekje të eliminonjë nga lista fituese Janina Ymerin dhe Ermal Sadikun. Votuesi nuk i votoi, nuk e dëgjuan dyshen karrieriste

anti-LDK dhe pro Kurthit. Sepse këta janë fryma e vërtetë e LDK-së. Këta janë opozita serioze kundër Kurthit, bashkë me Ramën prandaj edhe po luftohen tinëzisht nga Lumiri dhe Vojsa dhe në mënyrë të paskrupullt nga Vejusha e Zezë e sektit LV-së, spiunja e dyshuar greke dhe serbe, Dejona Mihali. Këta nuk duhet të bëhen shpinë dhe strehë për keqbërësit e pushtetit dhe për lakmitarët e posteve, Lumirit dhe Vojsës.

Nëse PDK-ja hynë në çfarëdo koalicioni me sektin e LV-së, lirish le të hapin të pame për vdekje të kësaj partie! E kam një dilemë rreth Doarsa Kicës që nuk po e mbron Ramën ndonëse buzët i ka të djegur nga çorba e LV-së. Doarsa nuk mund ta ndërtojë dhe forcojë personalitetin duke qëndruar nën hijen e këtij dyshi anti-LDK, Lumirit dhe Vojsës, Boni dhe Klajdit.

Si të veprojnë opozita: Opozita nuk duhet t'i pranojë rezultatet e votimit me postë dhe në përfaqësitë "diplomatike" që në fakt janë shndërruar në pika të sektit LV-së. Opozita po shpenzon kohë me gazin amerikan duke e përdorur si armë politike. Albin Kurthi do ta pranojë gazin amerikan dhe çdo gaz tjetër vetëm për të qëndruar në pushtet. Do të bindin shpejt. Nëse opozita i pranon këto rezultate të kurdisura dhe të vjedhura atëherë duhet t'i votojë sektit LV-së çdokënd që e propozon për kryetar Kuvendi, president dhe KM dhe pastaj duhet ta sjellë Zvërnecin në Kosovë. Autokratët nuk e pranojnë fuqinë e votës nëse iu del nga duart. Albin Kurthi është autokrat patologjik. Askujt nuk i beson, nuk është tolerant, është hakmarrës dhe shpërfillës ekstrem. Armiqtë i përndjek në baza personale dhe familjare. Prandaj, bazuar në drejtësinë hyjnore (është e pagabueshme) nuk mund ta ketë fundin e mirë dhe të dinjitetshëm. Drejtësinë tokësore e ka kapur! Kosova ka hyrë në një labirint dhe me Kurthin nuk del dot nga labirinti. Nëse ndodhë e kundërta, nuk kemi pse ta kundërshtojmë apo hidhërohemi. Përkundrazi!

ASK: TREGTIA ME PAKICË NË KOSOVË U RRIT MBI 9 % NË PRILL TË 2026-S

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë përveç Tregtisë së Automjeteve dhe Motoçikletave për muajin prill 2026. Në muajin prill 2026 indeksi i qarkullimit të tregtia me pakicë përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave kishte rritje për 9,29 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (prill 2025). Sipas aktivitetit ekonomik kishte rritje tek: Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje dhe Tregtia me Pakicë jo në dyqane (përmes postes apo internetit) 24,86 %; Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara 21,60 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 18,15 %; Tregtia

me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 13,71 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 10,33 %. Në muajin prill indeksi i numrit të punëtorëve të Tregtisë me Pakicë përveç Tregtisë së Automjeteve dhe Motoçikletave kishte rritje për 3,70 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Prill 2025), sipas aktivitetit ekonomik kishte rritje në: Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje dhe Tregtia me Pakicë jo në dyqane (përmes postes apo internetit) 9,93 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 9,70 %; Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar 5,66 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 5,64 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 2,88 %; Tregtia

me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 2,45 %; Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 1,87 %; Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 0,56 %. Në muajin prill indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve të Tregtisë me Pakicë, përveç Tregtisë së Automjeteve dhe Motoçikletave kishte rritje për 13,76 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (prill 2025), sipas aktivitetit ekonomik kishte rritje në: Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 21,18 %; Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje dhe Tregtia me Pakicë jo në dyqane (përmes postës apo internetit) 20,33 %; Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar 16,88 %; Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 16,61 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve



informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 16,59 %; Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 13,53 %; Tregtia

me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 11,49 %; si dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 7,50 %.

SHOQATA E NDËRTIMIT: PUNËTORËT TA REFUZOJNË PUNËN ATY KU U RREZIKOHET JETA

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Siguria në sektorin e ndërtimit në Kosovë vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore, ndonëse sipas Shoqatës së Ndërtimit në Kosovë, muajt e fundit janë shënuar përmirësime të dukshme në zbatimin e standardeve të sigurisë në vendpunishite. Kryetari i Shoqatës së Ndërtimit në Kosovë, Valon Vataj, në një prononcim për IndeksOnline, tha se niveli i sigurisë ende nuk është aty ku duhet të jetë, por theksoi se kompanitë po tregojnë përkushtim më të madh në mbrojtjen e punëtorëve. "Siguria në ndërtim mbetet ende jo në nivelin që të gjithë dëshirojmë, por përmirësimet e kohës së fundit janë të dukshme dhe inkurajuese. Ne



si Shoqatë e Ndërtimit në Kosovë jemi në monitorim të vazhdueshëm të situatës së sigurisë në sektor dhe kemi hasur në bashkëpunim të

shkëlqyeshëm me kompanitë ndërtimore, të cilat po tregojnë gjithnjë e më shumë përkushtim në zbatimin e masave të sigurisë, trajnimin e

punëtorëve dhe ngritjen e standardeve në vendpunishite", deklaroi Vataj. Ai theksoi se përgjegjësia për sigurinë nuk bie vetëm mbi kompanitë dhe institucionet, por edhe mbi vetë punëtorët. "Çdo punëtor duhet të refuzojë të punojë në vende ku rrezikohet jeta dhe shëndeti i tij, t'i përdorë pajisjet mbrojtëse personale dhe t'i respektojë procedurat e sigurisë në kantier", u shpreh ai. Vataj u bëri thirrje punëtorëve që të raportojnë çdo shkelje apo mungesë të masave mbrojtëse, duke theksuar se vetëm përmes reagimit të përbashkët mund të parandalohen aksidentet. "Njëkohësisht, i inkurajojmë punëtorët që në rastet kur

hasin në mungesë të masave të sigurisë ose në kushte të rrezikshme pune, të bëhen sinjalizues pranë institucioneve përgjegjëse dhe pranë Shoqatës së Ndërtimit në Kosovë, në mënyrë që të reagojmë së bashku për parandalimin e aksidenteve dhe ngritjen e standardeve të sigurisë në sektor", tha ai. Sipas kreut të Shoqatës së Ndërtimit, ndërtimi i një kulture më të fortë të sigurisë kërkon angazhimin e përbashkët të kompanive, punëtorëve, institucioneve dhe organizatave profesionale. "Vetëm përmes bashkëpunimit ndërmjet kompanive, punëtorëve, institucioneve dhe organizatave profesionale mund të ndërtojmë një kulturë më të fortë të sigurisë në vendet e punës".

Eurostat: Shqipëria ndër vendet me karburantin më të shtrenjtë në Evropë

TIRANË, 19 QERSHOR - Pavarësisht se Shqipëria mbetet ndër vendet me të ardhurat më të ulëta në Evropë, qytetarët e saj vazhdojnë të përballen me çmime të larta të karburanteve, duke paguar më shumë se mesatarja e Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave të publikuara nga Eurostat për vitin 2025, indeksi i çmimeve për karburantet dhe lubrifikantët në Shqipëri ka arritur në 110.5 % të mesatares së BE-së. Kjo

nënkupton se një konsumatori shqiptar i nevojiten 10.5 % më shumë para për të blerë të njëjtën sasi karburanti krahasuar me një qytetar mesatar evropian. Raporti bazohet në metodologjinë e fuqisë blerëse (PPP), e cila mat koston reale të mallrave dhe shërbimeve duke marrë parasysh nivelin e të ardhurave dhe çmimeve në secilin vend. Sipas renditjes evropiane, Shqipëria pozicionohet e pesta për

karburantet më të shtrenjta, pas Islandës, Danimarkës, Holandës dhe Zvicrës. Në të njëjtën kohë, vendi rezulton më i shtrenjtë edhe se shumica e vendeve të rajonit. Serbia dhe Mali i Zi regjistrojnë nivele më të ulëta çmimesh sipas fuqisë blerëse, ndërsa Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina renditen ndër vendet me karburantin më të lirë në Evropë. Turqia mban vendin e parë për çmimet më të ulëta të karburanteve në kontinent.



ÇFARË I MËSOI HORMUZI BOTËS

Pavarësisht krizës së Ngushticës së Hormuzit, ekonomitë ia dolën falë rezervave të mëdha, furnizimeve alternative dhe bumit të inteligjencës artificiale



Rihapja e Ngushticës së Hormuzit, si pjesë e një marrëveshjeje paqeje mes SHBA-së dhe Iranit, do të lehtësonte një krizë energjetike që ka dobësuar rritjen ekonomike dhe ka ushqyer inflacionin në mbarë botën. Megjithatë, një nga surprizat e mbylljes së kësaj arterie energjetike të Lindjes së Mesme ishte se ekonomia globale nuk pësoi një goditje më të rëndë. Dhimbja nuk ishte aq e fortë sa pas pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022, apo krizave të naftës në vitet 1970. Çfarë mësoi ekonomia globale nga kjo përplasje dhe kriza që ishte Hormuzi?

Vendet e përgatitura

Duke hyrë në krizën e Hormuzit, bota kishte shumë naftë në dispozicion. Importuesit kryesorë në Europë dhe Azi ishin të pajisur mirë me rezerva strategjike, ndërsa stoqet tregtare ishin në gjendje të shëndetshme pas grumbullimeve të mëdha gjatë vitit 2025. Kjo u dha shumë ekonomive një mburojë që kufizoi ndërprerjet. Në Mbretërinë e Bashkuar, shitjet e karburantit ranë në prill pasi njerëzit shmangën udhëtimet me makinë. Disa kompani ajrore europiane dhe amerikane shkurtuan oraret e fluturimeve për shkak të çmimeve më të larta të karburantit të avionëve. Në Japoni, një prodhues ushqimësh zëvendësoi ambalazhet me ngjyra me

ambalazhe bardhezi për disa produkte, si përgjigje ndaj mungesave të lidhura me naftën. Barrën më të madhe të krizës së furnizimit e mbajtën vendet më të varfra, që nuk kanë mundësi të krijojnë rezerva. Disa prej tyre, si Bangladeshi dhe Sri Lanka, morën masa për të kufizuar kërkesën për naftë përmes racionimit të karburanteve. Të tjerë mbyllën shkolla dhe zyra dhe kufizuan përdorimin e kondicionerëve. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë vlerësoi se kërkesa globale për naftë do të bjerë me rreth 5%, ose 5 milionë fuçi në ditë, gjatë tremujorit të dytë të vitit. Kjo është më pak se rënia prej 10% e kërkesës që u regjistrua gjatë Luftës Iran-Irak, embargos arabe të naftës në vitin 1973 dhe krizës së Kanalit të Suezit në vitin 1956, sipas Société Générale, duke treguar se goditjet e naftës janë bërë më të lehta për t'u menaxhuar.

Tregjet përshtaten

Frika se kriza e Hormuzit do ta çonte çmimin e naftës në 150 apo edhe 200 dollarë për fuçi nuk u materializua. Prodhuesit e energjisë në Lindjen e Mesme gjetën mënyra për të anashkaluar mbylljen e ngushticës më shpejt sesa kishin parashikuar shumë ekspertë, ndërsa prodhues të tjerë, përfshirë SHBA-në, rritën prodhimin dhe eksportet për të mbushur një pjesë të boshllëkut.

Eksportet nga porti saudit i Yanbu në Detin e Kuq u rritën në rreth 4 milionë fuçi në ditë, nga më pak se 1 milion para luftës, sipas kompanisë Kpler. Edhe Emiratet e Bashkuara Arabe rritën eksportet përmes tubacioneve, duke dërguar naftë nga Abu Dhabi në portin e Fujairah në Gjirin e Omanit. Ndërkohë, eksportet amerikane të naftës arritën nivele rekord. Eksportet e Venezuelës janë rritur me 43% gjatë tre muajve të fundit krahasuar me një vit më parë, ndërsa eksportet e Brazilit janë rritur me një të tretën, sipas Kpler.

Dora e fortë e Kinës

Importet kineze të naftës ranë me rreth 3 milionë fuçi në ditë, por pati pak shenja të dukshme ndërprerjesh. Ashtu si importuesit e tjerë të mëdhenj, Pekini përdori rezervat e tij strategjike dhe gjeti furnizues të tjerë për të zburuar humbjet nga mbyllja e ngushticës. Rafineritë ulën prodhimin për të kursyer naftën bruto. Por Kina, e vetëdijshme për varësinë e saj nga energjia e importuar, ka riorientuar ekonominë për të përdorur më pak naftë të importuar. Prodhimi i energjisë elektrike mbështetet gjithnjë e më shumë te qymyri dhe energjitë e rinovueshme, ndërsa drejtuesit kinezë kanë përqafuar me entuziazëm automjetet elektrike, duke ulur kërkesën për benzinë. Kriza nuk ishte pa kosto për

Kinën: çmimet e prodhuesve u rritën dhe shpenzimet e konsumatorëve ranë në maj. Megjithatë, ekonomia kineze tregoi më shumë qëndrueshmëri sesa ekonomitë e tjera aziatike, duke ndihmuar në mbështetjen e ekonomisë globale.

Efikasiteti global

Drejtoresha e Përgjithshme e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kristalina Georgieva, tha në prill se përmirësimet në efikasitetin energjetik po ndihmonin në zbutjen e goditjes së shkaktuar nga lufta. Një mënyrë për të matur sa efektivisht përdorin energjinë ekonomitë është të llogaritet sasia e energjisë që nevojitet për të prodhuar një dollar të Prodhitimit të Brendshëm Bruto. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, e korrigjuar për inflacionin, intensiteti energjetik ka rënë me rreth një të tretën që nga viti 2000 në SHBA dhe Europë, dhe me rreth 40% në Kinë. Ky ndryshim i ndihmon ekonomitë të përballojnë më mirë ndërprerjet e furnizimit. Ekonomitë e avancuara janë zhvendosur drejt shërbimeve më pak intensive në energji, si financat dhe kujdesi shëndetësor, larg sektorëve prodhues me konsum të lartë energjie. Burimet e rinovueshme kanë luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm, pasi energjia diellore dhe ajo e erës kërkojnë

më pak energji për t'u prodhuar sesa lëndët djegëse fosile. Pajisjet shtëpiake janë ridizajnuar për të përdorur më pak energji elektrike, ndërsa kompanitë kanë përmirësuar proceset industriale për të kursyer energji, një mësim që Europa e mori seriozisht pas pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022.

Bumi i inteligjencës artificiale

Bumi i inteligjencës artificiale ka qenë një kundërpeshë e rëndësishme ndaj krizës energjetike. Ndërtimi i shpejtë i qendrave të të dhënave në SHBA dhe entuziazmi për potencialin e teknologjisë kanë rritur tregtinë dhe investimet, duke shtyrë bursat drejt niveleve rekord. Përfitimet janë ndjerë më fort në ekonomitë aziatike që furnizojnë çipat e memories, makineritë dhe pajisjet elektronike të nevojshme për të fuqizuar bumit e AI-së. Vlera e eksporteve të Tajvanit është më shumë se dyfishuar që nga fillimi i vitit 2025. Eksportet e Koresë së Jugut janë rritur me gati 80%, ato të Singaporit me 40%, ndërsa eksportet e Japonisë janë rritur me rreth 20%. Kjo ethe teknologjike ka nxitur vull ekonomik në pjesë kyçe të ekonomisë globale, edhe ndërsa kriza e naftës ka goditur sektorë të tjerë. / The Wall Street Journal – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

KFV KOSOVA (P) SHPALLET KAMPIONE E LIGËS SË VETERANËVE

PRISHTINË, 19 QERSHOR - KFV Kosova (P) është shpallur kampione e këtij edicioni në Ligën e Veteranëve, pasi ka mposhtur KFV Prizrenin me rezultat 3:1, në një finale ku ekipi nga kryeqyteti ka treguar më shumë stabilitet dhe efikasitet.

Finalja për edicionin 2025/2026 është zhvilluar në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, duke sjellë një ndeshje mjaft interesante dhe me ritëm të lartë deri në fund.

Golashënues për KFV Kosova (P) ishin Azem Ahmeti në minutën e 6, Burim Shala në minutën e 32-të dhe Arben Fetahu në minutën e 42-të, ndërsa golin e vetëm për KFV

Prizrenin e ka realizuar Fatih Kahrahoda në minutën e 33-të. Pas përfundimit të ndeshjes, trofeu i kampionit i është dorëzuar kapitenit të ekipit fitues, Naser Prapashtica nga Enes Shosholli, kryetar i Ligës së Veteranëve të Kosovës dhe Avni Shala nënkryetar.

Lojtarët e KFV Kosova (P) për këtë titull i ka uruar presidenti i FFK-së, Agim Ademi. "Liga e Veteranëve vazhdon të dëshmojë se dashuria për futbollin nuk njih moshë, ndërsa futbollistët e gjeneratës së sakrificës mbeten ambasadorë të vlerave sportive dhe shembull për brezat e rinj. Urime për kampionët!", është thënë në urimin e Ademit.



KOSOVA MËSON KUNDËRSHTARIN PËR 'PLAY-OFF' TË KUPËS SË BOTËS 2027 PËR FEMRA

ROUND 1 - PATH 1

| | | |
|------------|------------|---------------------|
| LITHUANIA | MATCH 1 VS | SWEDEN |
| ROMANIA | MATCH 2 VS | NORWAY |
| GREECE | MATCH 3 VS | ENGLAND |
| CROATIA | MATCH 4 VS | ICELAND |
| KAZAKHSTAN | MATCH 5 VS | REPUBLIC OF IRELAND |
| KOSOVO | MATCH 6 VS | AUSTRIA |
| HUNGARY | MATCH 7 VS | NETHERLANDS |
| BELARUS | MATCH 8 VS | ITALY |

NYON, 19 QERSHOR - Në selinë e UEFA-s është hedhur shorti për fazën "play-off"-it të kualifikimeve për Kupën e Botës 2027 në konkurrencën e femrave, ku për herë të parë në histori pjesë e kësaj faze është edhe Kombëtarja e Kosovës.

Në ceremoninë e shortit, Federata e Futbollit e Kosovës është përfaqësuar nga shefja e futbollit të femrave, Valbona Gashi-Uka dhe trajnerja e Kombëtares A, Xhuli Berisha. Shorti ka përcaktuar që "Dardanet" në gjysmëfinalen e "play-off"-it do të përballen me Austrinë. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 9 tetor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, ndërsa sfida e kthimit do të luhet më 13 tetor në Austri. Në rast kualifikimi, Kosova në finalen e "play-off"-it do të ndeshet me fituesin e çiftit Izrael - Zvicër. Ndeshjet finale janë paraparë të zhvillohen më 1 dhe 5 dhjetor.

Arritja në këtë fazë paraqet një sukses historik për futbollin e femrave në Kosovë. "Dardanet" kanë siguruar vendin në "play-off" pasi kanë përfunduar me sukses ciklin kualifikues në Ligën C, duke u renditur në vendin e parë të grupit. Njëkohësisht, ato kanë siguruar edhe promovimin në Ligën B për edicionin e ardhshëm kualifikues.

Neuer konfirmon largimin nga Gjermania pas Botërorit

BERLIN, 19 QERSHOR - Portieri legjendar i Gjermanisë, Manuel Neuer, ka konfirmuar se Kupa e Botës 2026 do të jetë turneu i tij i fundit me kombëtaren, duke mbyllur kështu një kapitull të gjatë në karrierën ndërkombëtare. "Ky

do të jetë turneu im i fundit për Gjermaninë. Nuk kam ndërmend të marr pjesë në Kampionatin Evropian pas dy vitesh", ka deklaruar Neuer. Megjithatë, 38-vjeçari ka theksuar se nuk dëshiron të jetojë me presionin e

lamtumirës gjatë turneut aktual. "Dua të pres me padurim çdo ndeshje dhe të mos mendoj për lamtumirën apo ndeshjen e mundshme të fundit", ka thënë ai. Manuel Neuer është duke marrë pjesë në Kupën e Botës

për herë të katërt me Gjermaninë dhe mbetet një nga figurat më të rëndësishme të ekipit kombëtar, pavarësisht se është në fazën e fundit të karrierës së tij ndërkombëtare.



TAULANT XHAKA PËRFUNDON ME SUKSES PROGRAMIN UEFA A, NJË HAP I RI NË KARRIERËN SI TRAJNER

TIRANË, 19 QERSHOR - Ish-futbollisti i njohur shqiptar, Taulant Xhaka, ka përfunduar me sukses kursin e trajnerëve dhe është pajisur me diplomën UEFA A nga Shoqata Shqiptare e Futbollit. Certifikata e Konventës së Trajnerëve UEFA (Coaching Convention) dëshmon për përfundimin me sukses të këtij programi profesional, duke i hapur rrugën Xhakës për një kapitull të ri në botën e futbollit, por këtë herë nga banka. Me këtë arritje, Taulant Xhaka vazhdon ta ndërtojë profilin e tij në futboll, duke kombinuar përvojën e gjatë si lojtar me përgatitjen moderne për rolin e trajnerit. Licenca UEFA A është një nga licencat më të rëndësishme profesionale për trajnerë futbollit në sistemin e UEFA-s. Ajo nuk është thjesht një "diplomë kursi", por një kualifikim zyrtar që tregon se trajneri ka kaluar një program të strukturuar edukimi. Taulant Ragip Xhaka është rritur në Zvicër dhe është formuar si futbollist në

akademinë e FC Basel 1893. Ai ka bërë debutimin në futbollin profesionist me Baselin dhe është bërë një nga lojtarët më të qëndrueshëm të skuadrës. Ai ka luajtur kryesisht si mesfushor defensiv, duke u dalluar për: luftën në fushë dhe karakterin e fortë, disiplinën taktike, rikuperimin e topit dhe angazhimin maksimal në çdo ndeshje. Me FC Basel 1893, Xhaka ka fituar trofe kombëtarë dhe ka marrë pjesë në kompeticionet evropiane, përfshirë ndeshje në UEFA Champions League dhe UEFA Europa League. Në nivel kombëtar, Xhaka kishte zgjedhur ta përfaqësonte Kombëtarja e Shqipërisë. Ai ishte pjesë e brezit historik shqiptar që ishte kualifikuar në UEFA Euro 2016, turneu i parë evropian në historinë e Shqipërisë. Në atë periudhë, Xhaka ishte një nga figurat e rëndësishme të ekipit. Pas përfundimit të karrierës si futbollist, Taulant Xhaka ka nisur rrugëtimin në botën e trajningut, duke marrë



licencën UEFA A, një hap drejt një karriere të re si trajner. Ai është gjithashtu vëllai i Granit Xhakës, kapiteni i Kombëtares

së Zvicrës dhe një prej mesfushorëve më të mirë në botë. Taulant Xhaka mbetet i vlerësuar për

profionalizmin, besnikërinë ndaj klubit dhe kontributin në futbollin shqiptar dhe ndërkombëtar.

XHAKA UA MBYLL GOJËN KRITIKËVE PAS GOLIT NDAJ BOSNJËS, FESTA NË FUND HEDH POSHTË ZËRAT PËR PËRÇARJE



LOS ANGELES, 19 QERSHOR - Granit Xhaka ka qenë sërish në qendër të vëmendjes në fitoren e Zvicrës 4-1 ndaj Bosnjë-Hercegovinës në raundin e dytë të Grupit B në Kupën e Botës 2026 jo vetëm për golin e shënuar në fund të ndeshjes, por edhe për reagimin pas tij, në një moment që ka marrë vëmendje të madhe mediatike për shkak të raportimeve mbi tensione në kampin zviceran. Kapiteni i Zvicrës ka realizuar

gol nga pika e bardhë në minutën e 98, duke vulosur fitoren bindëse të skuadrës së Murat Yakin dhe duke e mbyllur ndeshjen me rezultat 4-1. Megjithatë, më shumë se vetë goli, vëmendjen e ka marrë festa e tij: një gjest i drejtuar drejt publikut dhe më pas përqafimi me bashkëlojtarët, duke dhënë sinjal uniteti në një moment kur jashtë fushës po qarkullojnë raportime për

pakënaqësi në dhomën e zhveshjes. Sipas medieve zvicerane dhe ndërkombëtare, përfshirë raportime të fundit, është përfolur për një atmosferë të tensionuar brenda ekipit pas deklaratave kritike të Xhakës ndaj performancës së skuadrës në ndeshjen e parë të turneut. Megjithatë, paraqitja ndaj Bosnjës dhe sidomos goli i fundit duket se kanë treguar një realitet tjetër në fushë. Zvicra jo

vetëm që ka dominuar ndeshjen, por edhe ka shfaqur kohezion të fortë në momentet vendimtare, duke shënuar tre gola në pjesën e dytë përpara se Xhaka ta vulte rezultatit nga penalltia. Në fakt, skena e festës pas golit të tij është interpretuar si një kundërpërgjigje ndaj zërave për përçarje. Lojtarët e Zvicrës janë mbledhur rreth kapitenit, duke festuar së bashku, një imazh në kontrast me

raportimet për "tensione" dhe "pakënaqësi" në kampin e skuadrës. Zvicra me këtë fitore ngjitet në krye të Grupit B me katër pikë dhe hedh një hap të madh drejt fazës eliminatorie, ndërsa Xhaka, përveç kontributit në rezultat, rikthehet edhe një herë në qendër të debatit mbi rolin e tij si lider, mes kritikave dhe momenteve që në fushë flasin ndryshe nga zërat jashtë saj.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “GOPA Infra Gmbh” Dega në Kosovë, SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810842717 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “GOPA Infra Gmbh” Podružnica na Kosovu, D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810842717 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “GOPA Infra Gmbh” Branch in Kosovo, L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810842717 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Ardita” SH.P.K. Shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit me nr. 810232546 të lëshuar nga ARBK.
- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë Fizioterapi.
- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.
- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.
- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.
- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- “Restorant te Besi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.
- “Flemingo Kosovo” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.
- Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.
- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.
- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK “11 Marsi” Prizren.
- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.
- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. “ Ibrahim Fehmiu” Prizren.
- Çlirim Gjurar nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.
- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK “11 Marsi” Prizren.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.
- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

